28. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1 Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

I. ANKESAT

29. Procedura e ankesës .1 Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin dhe /ose përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për t'u ftuar për të paraqitur oferta, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

30 Anulimi i procedurës 1 Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2 Autoriteti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP.

3. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

-
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

4. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të pikes 3, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Kërkesës për pjesëmarrje

Shtojca 2. Ftesa për Ofertë për kandidatët e përzgjedhur faza II

Shtojca 3. Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 4 Lista e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 5. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 6. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 7. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 8. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 9. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 10. Formulari i Kriterëve Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 11. Formulari i Përmbledhës i Vetdeklarimit

Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 13. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 14. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 15. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 16. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1

(Shtojca për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik)

FORMULARI I KËRKESËS PËR PJESËMARRJE

Emri i **Operatorit Ekonomik** _____

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e autoritetit /entit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Numri i procedurës / referenca e Lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Botimi (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, në, të nënshkruarit paraqesim shprehjen tonë të interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 2

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor vetëm për operatorët ekonomikë të kualifikuar/
përzgjedhur bazuar në kërkesen per pjesëmarrje)*

FORMULAR I FTESËS PËR OFERTË

[Datë]

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të kualifikuar /përzgjedhur]*

Procedura e prokurimit _____/

Numri i procedurës / referenca e Lotit _____

Në referencë të procedurës së lartpërmendur ju bëjmë me dije se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë Ju jeni kualifikuar për fazën ofertuese të kësaj procedure prokurimi.

Për këtë arsye, ju kërkohet të paraqisni pranë [këtij autoriteti/enti kontraktor]

Emri _____

Adresa _____

Ofertën tuaj, duke marrë në konsideratë si më poshtë:

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertës është:

Data (d/m/v)

Ora: _____

Adresa _____

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën në formë elektronike në ueb-faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:

Shqip Anglisht

Tjetër _____

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

A) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto**

Sipas rëndësisë:

Çmimi pikët

_____ pikët

_____ pikët

_____ pikët

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për cdo kriter vlerësimi të përcaktuar.

OSE

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasi të janë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e kontratës;
3. Kriteret e përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
---	--

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë shërbimet në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbime Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbim i	Përshkrimi i shërbimit	Sasia kg	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.	Shërbim lavanderie për Spitalin Psikiatrik "Sadik Dinci" Elbasan dhe qendrat ne varesi te tij	726 925.6			
				Çmimi total (Shërbimet)	_____
Çmimi Neto pa TVSH					

TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
 [*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-
 se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimet teknike të Menaxhimit të Proçesit të Lavanderisë per Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan dhe qendrave te rehabilitimit ne varesi te tij.

- Operatori i kontraktuar duhet te ofroje sherbimin e grumbullimit te te gjithë inventarit te bute te papaster ne baze te rregullores se parandalimit te infeksioneve nozokomiale, trasportimin e tij ne lavanderi, seleksionimin, larjen, hekurosjen, paketimin, trasportimin serisht mbrapsht ne Sherbime (ku materiali i lare nuk duhet te kete kontakt me materialin e palare per te shmangur infeksionet), deri ne shtratin e pacientit, per 6 (gjashte) ditet e javes nga ora 7:00 deri ne oren 15:00, dhe pas ores 15:00 do te lihet ne dorezim baze materiale rezerve sipas kerkeses se pergjegjeseve te materialit ne pavione per nevoja te sherbimit gjate shtrimeve te reja naten, urgjencave, etj.
- Punesimin e nje numri te konsiderueshem personeli per ofrimin e sherbimit;
- Lejohet qarkullimi dhe qendrimi i mjeteve dhe mekanizmave te operatorit te kontraktuar, në territor pa pagesë, ndërsa operatori i kontraktuar i ruan vetë ato.
- Depot e materialeve të buta në pavijonet ku do të kryhet shërbimi do të vihen ne dispozicion te operatorit te kontraktuar pa kundershperblim.
- Autoriteti Kontraktos percakton vendin e depozitimit te teshava te papastra brenda territorit te Spitalit Psikiatrik Elbasan.

Duke pasur parasysh natyren spitalore, eshte e domosdoshme dhe e rendesishme, qe materiali i bute per tu lare duhet te terhiqet sa me shpejt nga pavionet, bazuar ne manualet e kujdesjeve spitalore dhe rregullave te higjenes (selektimi sipas ndotjes se materialit te bute ne thaset me ngjyre). Mos largimin ne kohe i ketij materiali, do te conte ne rritjen e infeksioneve spitalore me efekt final uljen e performaces se ofrimit te sherbimit ndaj pacienteve, rritjen e diteqendrimit, rritjen e perdorimit te medikamenteve (kryesisht antibiotikeve).

Operatori ekonomik privat qe do te kontraktohet, duhet te ofroje nje sherbim i cili do te perfshije:

- Grumbullimin e materialit te bute te papaster ne te gjitha pavionet e Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan, sipas grafikeve te percaktuar, rregulloreve dhe protokolleve te higjenes dhe manualeve te kujdesit spitalor;
- Larje e materialit te bute;
- Hekurosjen dhe paketimin e materialit te bute;
- Shperndarjen e materialit te bute ne te gjitha klinikat e Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan, dhe qendrat ne varesi “Jeta” Cerrik dhe “Drita” Elbasan sipas grafikeve te percaktuara;

Sherbimi do te ofrohet gjate gjithë javes prej dites se hene deri dite e shtune (operatori ekonomik privat, duhet te siguroje edhe materialin e bute per mbulimin e nevojave ne pavione) si dhe lenien e bazes materiale rezerve per nevoja te sherbimit gjate shtrimeve te reja naten, urgjencave, por edhe sipas grafikut te

percaktuar per nderrimin periodik te materialit te bute ne sherbimet perkatese, dhe sipas kerkeses se pavionit ne rast te nderrimit te materialit te bute kur behet i domosdoshem per paciente te vecante.

Perdorimi i bazes materiale te lene rezerve gjate nates nga K/Infermierja e klinikes ose personi i autorizuar prej saj do te pasqyrohen ditën e nesërme me procesverbal te firmosur nga te dyja palet dhe do ti dorezohet nje kopje deges se hotelerise.

Ne rast konstatimi te mungeses dhe/ose demtimit te inventarit (te shtruar dhe rezerve) te bute per periudhen e lene ne admistrim te personelit te Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi”Elbasan, do te mbahet nje procesverbal, i firmosur nga te dyja palet, nje kopje e te cilit do te dorezohet ne sektorin e hotelerise dhe operatori i kontraktuar do te beje menjehere zevendesimet perkatese.

Per rastet e humbjes dhe/ ose demtimit te inventarit (te shtruar e rezerve) te bute, te evidentuara me procesverbalet perkatese, do te behet zhdemtimi (rimbursimi) nga ana e Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi”Elbasan, per llogari te Operatorit te kontraktuar; ne baze te kartelave perkatese financiare dhe perpilimit te fatures tatimore nga ana e operatorit te kontraktuar.

Marredheniet financiare fillojne me nenshkrimin e kontrates. Spitali Psikiatrik “Sadik Dinçi”Elbasan, likujdon cdo muaj Operatorin e Kontraktuar bazuar ne sasine e materialit te bute te thate ne kg qe e dorezon ne pavijonet perkatese. Procesverbali firmoset nga perfaqesuesit e te dyja paleve dhe nje kopje e tij dorezohet cdo dite ne Degen e Hotelerise, e cila harton edhe permbledhesen ne shkalle spitali. Te dhenat e permbledheses rakordohen çdo fund muaji me Operatorin e kontraktuar dhe sherbejne per likujdimin e punes se kryer bazuar ne koston e 1 kg material te thate.

Tërheqja dhe dorëzimi i inventarit të materialit të butë në klinika, do të bëhet me grafik të hartuar nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise së Spitalit. Grafiku është i detyruar të zbatohet nga të dyja palët, dhe në rastet e ndryshimit të tij, miratimi duhet të bëhet me nënshkrim po nga të dyja palët.

Përdorimi i inventarit të materialit të butë brënda klinikes , bëhet dhe mbetet nën përgjegjësinë e personelit të sipërmarrësit të kontrolluar nga autoriteti kontraktor, sipas procedurave të mëposhtme:

Etapat e këtij procesi çdo ditë:

- Çdo ditë K/infermierja e klinikes ose personi i autorizuar prej saj, përpilon, siglon dhe dorëzon, kërkesën (Fletë Forcën e klinikes) për ditën e nesërme për material të butë, duke cilësuar numrin shtrimeve të reja, të cilën e dorëzon brënda orës 12:00 tek Sektori i Sherbimeve te Hotelerise të Spitalit.
- Sektori i Sherbimeve te Hotelerise të Spitalit, në bazë të kërkesave ditore (fletëve të forcave të klinikes) dhe grafikut të klinikave, harton evidencën ditore permbledhëse ne total per gjithë Spitalin, dhe ia dorëzon sipërmarrësit brënda orës 13:00 për ditën pasardhëse.
- Peshimi dhe numërimi i materialit të butë të larë, të thatë, të hekurosur, si dhe të pakeluar do të bëhet çdo ditë në ambjentet që do caktohen nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës, çdo ditë në orën 08:00 nën prezencën e përfaqësuesit të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të sipërmarrësit, duke mbajtur proces-verbalin përkatës të firmosur nga palët. Ky dokument do ketë vlerë financiare, pasi likuidimi i operatorit ekonomikë do të bëhet mbi bazën e proces verbaleve të nënshkuara nga palët për çdo ditë.
- Vetëm pasi të jetë peshuar dhe numëruar, materiali i butë është gati për tu shpërndarë nga Sipërmarrësi në shërbimet përkatëse, sipas kërkesave të shërbimit të bërë një ditë më parë. Materiali i bute do i palare do dale me cope dhe do hyje i lare me kilograme.

- **Shpërndarja e materialit të butë** në klinika, do të bëhet nga sipërmarrësi çdo ditë pas orës 7:00 deri në orën 15.00, sipas grafikut të përpiluar sektori i Hotelerise dhe miratuar nga palët.
- Sipërmarrësi ia dorëzon materialin e butë Kryeinfermierit të klinikës në bazë të grafikut të hartuar nga Sektori i Hotelerise. Për çdo rast, dorëzimi i materialit të butë do të bëhet vetëm pasi ky material i butë të jetë peshuar, numëruar dhe në momentin e dorëzimit do të mbahet procesverbali i dorëzimit (ne kilograme) i firmosur nga të dyja palët, nga Grupi i pritjes së mallit si dhe nga Kryeinfermieri i klinikës, në 3(tre) kopje. Kryeinfermieri i klinikës dhe Grupi i pritjes së mallit bën kontrollimin për larjen, hekurrosjen, cilësinë e materialit të butë dhe në rast kostatimi të materialit të butë difektoz ose të papastër, e kthen mbrapsht duke e pasqyruar në procesverbal. Ky procesverbal duhet të ketë të saktësuar numrin e materialit të butë të marrë në dorëzim nga Kryeinfermieri i klinikës.
- K/infermierja e klinikës ose personi i autorizuar prej saj se bashku me Grupin që pret mallin, do të evidentojnë dhe konfirmojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimin që kryhet, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do të konfirmojnë dhe informojnë me shkrim në Sektorin e Hotelerise të Spitalit.
- Tërheqja e materialeve të buta të ndotura nga klinika, do të bëhet nga sipërmarrësi deri në orën 15.00, duke iu referuar Rregullores në parandalimin e infeksioneve spitalore.
- Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës, prej ditës së hënës deri ditën e shtunë, (operatori ekonomik duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në klinika, dhe shtrimin e shtratit të pacientit, gjatë fundjavës) gjatë 8 orëve, ndërsa për Klinikën e Pranimi do të jete 24-orësh, edhe sipas kërkesës së Kryeinfermierit të klinikës në rast se ndryshimi i materialit të butë bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.
- Në të gjitha rastet, kur shërbimet kanë nevojë për material të butë shtesë, vetëm pas miratimit të kërkesës nga Sektori I Hotelerise, Sipërmarrësi do të procedojë me dorëzimin e materialit të butë shtesë, të kërkuar nga shërbimi.
- Në raste të konstatimit të mungesave dhe/ose dëmtimit të materialit të butë për periudhën e lënë nën administrim e personelit të Spitalit, do të mbahet një procesverbal, të firmosur nga të dyja palët, një kopje e të cilit do të dorëzohet në sektorin e Hotelerise dhe sipërmarrësi do të bëjë menjëherë zëvendësimet përkatëse.
- Riparimi i materialit të butë të dëmtuar, bëhet nga sipërmarrësi duke ruajtur përmasat, dimensionet, përbërjen fillestare (të gjitha specifikimet teknike të materialit të butë).
- Sipërmarrësi detyrohet të zëvendësojë materialin e butë të vjetëruar në përdorim me material të butë të ri sipas jetëgjatësisë së çdo materiali të butë dhe sipas nevojës.
- Në të gjitha rastet kur sipërmarrësi dhe/ose autoriteti kontraktor konstatojnë material të butë të dëmtuar, të dy palët mbajnë një proces verbal dhe më pas procedohet me nxjerrjen nga përdorimi të këtij materiali të butë.
- Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që do të vendos Drejtoria e Spitalit.
- Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë në prani të përfaqësuesit të sipërmarrësit, dhe të përpilojë akt kontrole nga sektorë të ndryshëm të saj, në bazë të programeve të punës, për të evidentuar çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e shërbimit, sasinë e materialit të butë të dorëzuar duke rakorduar dhe mbajtur procesverbale përkatëse të shërbimit.

- I gjithë materiali i butë në përdorim, me përfundimin e kontratës, i dorëzohet Spitalit pa kundërpaguesë.
- Të gjitha kostot për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin Psikiatrik Elbasan do të sigurohen nga vetë sipërmarrësi.
- Marrëdhëniet financiare midis palëve, do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës.
- Spitali likujdon çdo muaj Sipërmarrësin, bazuar në sasinë e materialit të butë të thatë në kilogramë sipas procesverbaleve të peshimit dhe përmbledhëses mujore të forcës së pavionit, të hartuar nga Sektori i Hotelerisë dhe të miratuar nga të dyja palët. Sektori i Hotelerisë, harton përmbledhësen mujore, duke u bazuar në kopjet e procesverbalit të dorëzimit të materialit të butë në klinika çdo ditë.
- Kur sipërmarrësi nuk bën ndërrimet e materialit të butë të shtratit të pacientit sipas afateve të përcaktuara, me ankesën me shkrim të klinikës, përfaqësuesi i Spitalit përpilon informacionin përkatës duke i bashkëngjitur një proces – verbal, në bazë të të cilit vërtetohet se nuk është kryer shërbimi. Për çdo ditë, shtrati që nuk është ndërruar në afat, sipërmarrësi i mbahet vlefte e llogaritur e materialit të butë të thatë që nuk është ndërruar. Në rastet kur mungesa e shërbimit përsëritet, sipërmarrësi i paguan gjobë Spitalit , sa dhjetëfishi i vlerës së shërbimit të munguar të llogaritur në shërbim.
- Proces – verbalet për ndalesat dhe gjobat, i mbahen sipërmarrësit në pagesën mujore të radhës. Ato mund të kundërshtohen nga sipërmarrësi në Drejtorinë e Spitalit brenda muajit (30 ditë) vijues. Jashtë këtij afati, këto procese do të quhen të pranuar nga palët.
- Personeli që punësohet nga sipërmarrësi në shërbimin e lavanderisë, brenda territorit të Spitalit, është i detyruar të zbatojë protokollin e kujdesit të higjienës, të kujdesit infermieror, si dhe rregulloren e Spitalit. Në rastet kur kjo shkelet, punonjësi përkatës largohet nga puna nga sipërmarrësi me kërkesën me shkrim të Drejtorisë së Spitalit, informacionit dhe proces verbalit përkatës.

Sasia e materialeve te buta per larje:

Materiali i bute qe do te lahet nga operatori ekonomik, grupohet ne 2 (dy) kategori:

- Material i bute per paciente
- Material i bute per personelin

Ne vijim do te jepen te detajuar lloji i materialit te bute qe do te lahet per sejcilen nga kategorite e siperpermenduar, si dhe perlllogaritja e sasise se materialit qe do te lahet mbi bazen vjetore, javore e ditore.

1. Persa i perket materialit te bute per paciente operatori ekonomik duhet te laje keto materiale:

Kellef dysheku
Jastek
kellef jasteku

Faqe jasteku
Çarçafe
Batanije
Peshqire
Peshqire banjo
Bluza pambuku te brendshme
Mbathje trikotazhi (gra)
mbathje trikotazhi (burra)
Pantallona pizhamash burrash
Xhakete pizhamash
Fustane te trikotuara
Kemisha fanellate (gra)
Fustane basme
Mushama e gomuar
Xhupa
Kostume sportive dimerore gra
Kostume sportive dimerore burra
Kostume verore gra
Kostume verore burra
Pizhama per gra
Pantallona xhins (burra)
Çorape

2.Se fundi, prej materialit te bute te stafit mjekesor eshte menduar te lahen:

- Perparese mjeku
- Kostum infermieri,kujdestari
- Kostum sanitare

Nderrimi i shtratit te pacientit do te behet cdo tre dite ose dy here ne jave, si dhe ne cdo rast qe kerkoet nga Kryeinfermierja e klinikës, si pasoje e shtrimit me paciente te rinj ose ne rast kur nderrimi i shtratit behet i domosdoshem per te ruajtur dhe mbrojtur shendetin e pacientit. Gjithsesi, ne sherbime te vecanta ky nderrim do te kryhet sa here te jete i nevojshem.

Per cdo ndryshim nga ana e porositesit te struktures se parashikuar ne tabelen me siper, Autoriteti Kontraktor ne marreveshje me Operatorin e Kontraktuar do te perfshije ne nje marreveshje te vecante sherbimi shtesen e sherbimit qe do te kerkoet.

Nisur nga numri i shtreterve dhe nga koeficienti i perdorimit te shtratit, mbi te cilin per sa me siper kemi percaktuar edhe numrin e shtreterve qe duhet te kompletohen, operatori ekonomik duhet te kete gjendje dhe ne perdorim inventarin ne vijim ne nje vit:

nr.	Emërtimi I materialit	normativa	njesia	sasia inventar
1	Dyshek	1 ne 2 vjet	cope	324
2	Kellef dysheku	1 ne vit	cope	324
3	Jastek	1 ne 2 vjet	cope	324

4	kellef jasteku	4 ne vit	cope	1,296
5	Faqe jasteku	2 ne vit	cope	648
6	Çarçafe	8 ne vit	cope	2,592
7	Batanije	4 ne 4 vjet	cope	324
8	Peshqire	3 ne vit	cope	972
9	Peshqire banjo	1 ne vit	cope	324
10	Bluza pambuku te brendshme	4 ne vit	cope	1,296
11	Mbathje trikotazhi (gra)	12 ne vit	pale	1,320
12	mbathje trikotazhi (burra)	10 ne vit	pale	2,140
13	Pantallona pizhamash burrash	6 ne vit	cope	1,284
14	Xhakete pizhamash	4 ne vit	cope	856
15	Fustane te trikotuara	3 ne vit	cope	330
16	Kemisha fanellate (gra)	3 ne vit	cope	330
17	Fustane basme	3 ne vit	cope	330
18	Kepuce	2 ne vit	pale	648
19	Pandofla gome	2 ne vit	pale	648
20	Mushama e gomuar	3 ne vit	ml	972
21	Xhupa	1 ne vit	cope	324
22	Kostume sportive dimerore gra	3 ne vit	pale	330
23	Kostume sportive dimerore burra	2 ne vit	pale	428
24	Kostume verore gra	2 ne vit	pale	220
25	Kostume verore burra	2 ne vit	pale	428
26	Pizhama per gra	2 ne vit	pale	220
27	Pantallona xhins (burra)	1 ne vit	pale	214
28	Çorape	12 ne vit	pale	3,888
29	Perparese mjeku (burash,grash)	1 ne vit	cope	22
30	Kostum kujdestari	1 ne vit	cope	47

31	Kostum infermieri (burrash, grash)	1 ne vit	cope	68
32	Kostum sanitare	1 ne vit	cope	39

Inventari per veshjen e personelit eshte llogaritur ne baze te numrit te punonjesve qe ka sot Spitali Psikiatrik “Sadik Dinçi”Elbasan, sipas normativave ketij personeli.

Nr.	Emertimi	Inventar ne Perdorim	normativa
1	Perparese Mjeku	22	1 ne vit
2	Kostum Kujdestari	47	1 ne vit
3	Kostum Infermieri	38	1 ne vit
4	Kostum Sanitari	39	1 ne vit

Volumi i punes i lavanterise per nje vit do te jete: 181,731.4 Kg ne vit

Pervec larjes operatori i kontraktuar duhet te riparterije materialin e bute sipas tabelës ne vijim:

Cilesojme se i gjithë materiali qe do te riparterihet duhet te permbaje logon dhe emertimin e Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi”Elbasan, materiali I secilës klinikë apo qender rehabilitimi te kete shenja dalluese per mos ngaterrimin e tyre pas procesit te larjes apo kthimit perseri ne klinikë. Gjithashtu edhe materiali i bute veshje personeli duhet te kete shenjat dalluese sipas pozicioneve.

Rrobat e papastra te dy qendrave ne varesi te spitalit tone qendra “Jeta” Cerrik dhe “Drita” Elbasan do te terhiqen nga operatori ekonomik fitues prane ketyre qendrave sipas grafikut te percaktuar nga autoriteti yne.

Specifikimi i Materialeve:

1	Dyshek tek	te jete me permasa 200x90 cm,me dy shtresa vatine,me pellush ne njerin krah,ana tjeter damask i plote
2	Kellef dysheku	Material cilesise se pare, permasat 200x90, ne perimetrin e tij me llastik te forte.
3	Jasteke	Te jete me mbushje sintetike uniforme,me dy kllaf ku njeri me zinxhir,me permasa80x40 cm,ngjyre te bardhe,me peshe 800 gr.
4	Kellef jasteku	Te jete 100% pambuk,me ngjyre te bardhe ,me permasa 80x50 cm,pesha 120 gr/m ² .

5	Faqe jasteku	kllef ku njera ane me zinxhir,me permasa80x40 cm, material bute.
6	Carcafe tek te siperm	Te jete 100% pambuk,kabot I zbardhur,thurje garniture, me permasa270x170 cm,160-180 gr/m ²
7	Carcafe tek i poshtem	Te jete 100% pambuk kabot I zbardhur,thurje garniture,me permasa 270x170 cm,me tegel net e 4 anet,peshe 160-180 gr/m ²
8	Batanije	te jete 60% lesh dhe 40 % akrilik,me permasa240x170 cm,ngjyre bezhe ose blu
9	Peshqire duarsh	Te jene 100% pambuk,me ngjyra te ndryshme,me permasa 90x 60 cm
10	Peshqire banjo	Te jete material 100% pambuk, ngjyra te ndryshme ,me permasa 150x80 cm
11	Bluza pambuku te brendshme	Te jene material 100% pambuk,me jake te rrumbullaket,me menqe te gjata,me ngjyre te bardhe,nr.te ndryshme sipas porosise
12	Mbathje trikotazhi burrash	Te jene material trikotazhi,100% pambuk,me kembeza,ngjyre te bardhe,nr. te ndryshem
13	Mbathje trikotazhi grash	E njejte me mbathjet e burrave por pa kembeza
14	Pantallona bizhame (fanellate)	Te jete material fanellate 100% pambuk,me ngjyra dhe nr te ndryshme
15	Xhakete bizhame (fanellate)	Te jete material fanellate 100% pambuk,me ngjyra dhe nr te ndryshme E njejta per te plotesuar kompletin
16	Fustane te trikotuara	Te jene trikotazh,100% pambuk,Nr te ndryshem
17	Kemisha fanellat grash	Te jete material fanellat 100% pambuk,nr te ≠
18	Fustan basme	Te jete material basme,nr te ndryshem.
19	Kepuce per burra	Kepuce 100% lekure, me shtrese ortopedike, nr.te ndryshem sipas kerkeses se autoritetit,pa lidhëse.
20	Kepuce per gra	Kepuce % lekure me shtrese ortopedike, nr. te ndryshem sipas kerkeses se autoritetit,pa lidhëse
21	Pandofla dimerore (burrash, grash)	Te jete material plastik,me gome poroze dhe pjesa e perparme e mbyllur, me ngjyre dhe nr. te ndryshem.
22	Pandofle verore (burrash,grash)	Te jene material plastik,me gome,nr dhe ngjyra te ndryshme.

23	Mushama e gomuar	Kellef dysheku I gomuar, Te jene material impermeabel(pa pershkushem nga uji),me permasa 200x90 cm Kater anet me llastik per tu fikesuar
24	Xhupa burrash	E njejte si tek grate pervec pjeses se fundit te jete me lileto te trikotuar si tek menget.Nr dhe ngjyra sipas kerkeses.
25	Xhupa grash	Te jene material feshfeshë e pa depertueshme nga uji,ne pjesen e brendeshme e veshur me pellush dhe jaka me pellush e c' montueshme, me dy xhepa anesore,manshet trikotazhi tek menget.Nr dhe ngjyra sipas kerkeses se entit prokurues.
26	Kostume sportive dimerore(burrash,grash)	Te jene 80% pambuk me 20 % poliester,thurje e plote,pjesa e brendeshme me push,xhketa me zinxhir dhe menga me manshet,tutat me lastikte pjesa e belit, ngjyra dhe nr sipas autoritetit.
27	Kostume sportive verore(Burrash + grash)sipas porosise se autoritetit kontraktor	te jene 80% pambuk dhe 20% poliester te perbera nga bluza me minge te shkurtra te shoqeruara me pantallona te shkurtra, pak siper gjurit me llastik ne mes, me ngjyra dhe permasa te ndryshme
28	Pizhama Grash	Te jete material i trikotuar,I plote,me ngjyra sipas kerkeses,pesha 350 gr/m ² ,pantallonat me llastik,xhaketa me jake kemishe ose jake V-je sipas kerkeses se entit prokurues,me kopsa perpara dhe dy xhepa.
29	Pantallona xhins	Te jene 100% me perberje panbuku me ngjyre blu dhe te zeze, me xhepa para dhe mbrapa. Te mberthehen me zinxhir
30	Çorape (per burra apo gra te cilesohet nga autoriteti)	Te jene 60% pambuk dhe 40% akrilik,nr dhe ngjyra sipas kerkeses se entit prokurues
31	Perparese mjekesh (burra, grash percaktohet nga autoriteti kontraktor)	<u>1. Përparëse mjekësh (burrash/grash)</u> Të jenë 65% pambuk-35% poliester, Masa 200—220 gr/m ² , ngjyrë e bardhë. Përparëset të jenë të masave të ndryshme. (S,M,L,XL). Të jenë burrash/grash sipas kërkesës së AK.Me mëngë të gjata,me kopsa me perçina,dhe me dy xhepa anash,me logon MSHMS dhe emërtesën e spitalit"Spitali Psikiatrik Elbasan,pjesa e mbrapme me të çarë.
32	Kostum infermieri (burra, grash percaktohet nga autoriteti kontraktor)	<u>2. Kostume bojëqielli për infermierë</u> Bluze+Pantallona unisex.Bluza me jakë V të trashë,me mëngë të shkurtra(tre cerekshe) dhe dy xhepa anësorë poshtë,me logon MSHMS dhe emërtesën e

		institucionit(Spitali Psikiatrik Elbasan).Të jenë 65 % poliester 35% pambuk, Masa 180-200gr/m ² , nr. të ndryshëm sipas kërkesës së AK.
33	Kostum kujdestari (burra, grash percaktohet nga autoriteti kontraktor)	Bluze+Pantallona unisex me xhepa, ngjyrë blu .Bluza me jakë V të trashë,me mëngë të shkurtra(tre cerekshe) dhe dy xhepa anësorë poshtë,me logon MSHMS dhe emërtesën e institucionit(Spitali Psikiatrik Elbasan).Të jenë 65 % poliester 35% pambuk, Masa 180-200gr/m ² , nr. të ndryshëm sipas kërkesës së AK.
34	Kostum sanitare	<u>3.Kostume Sanitare (bluzë+pantallona)</u> Bluze+Pantallona unisex me ngjyrë vishnje të errët. .Bluza me jakë V të trashë,me mëngë të shkurtra(tre cerekshe) dhe dy xhepa anësorë poshtë,me logon MSHMS dhe emërtesën e institucionit(Spitali Psikiatrik Elbasan).Të jenë 65 % poliester 35% pambuk, Masa 180-200gr/m ² , nr. të ndryshëm sipas kërkesës së AK.

Shtojca 8

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Shërbim i Lavanderise dhe hotelerise për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan dhe qendrat në varësi të tij

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimi	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Shërbim lavanderie dhe hotelerie për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan dhe qendrat ne varesi te tij	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	726 925.6 kg	Spitali Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Shtojca 9

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve

Kryerja e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan

Pershkrimi

Personeli i sipërmarrës, që kryen procedurat si në shtrimin e shtratit të pacientit ashtu dhe në terheqjen e materialeve të ndotura, duhet të ketë veshjet identifikuese për procedurat që kryen dhe të jetë i pajisur me kartën identifikuese, të njohur nga autoriteti kontraktor. Ai duhet të zbatojë protokollin e kujdesit infermieror në shtrimin e shtratit të pacientit si dhe rregullat e higjenes.

Shpërndarja :

Spitali Rajonal Elbasan dhe qendrat në varësi të tij

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe qendrat në varësi të tij Qendra “Jeta” Cerrik , Qendra “Drita” Elbasan.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë

qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 10 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Të dhënat e ambientit të kërkuar që do të deklarohet, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

